



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 43
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I
Prishtinë, më 16 nëntor 2016, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fadil Beka, Mirjet Kalludra, Besa Baftiu dhe Ali Berisha.

Munguan: Fikrim Damka, Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Të ftuar: Arban Abrashi, Ministër i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Osman Osmani, përfaqësues i Sindikatës së Punëtorëve në Zvicër UNIA, Bardhyl Gashi, drejtor i Shoqatës së Endokrinologëve dhe Diabetologëve, Luan Gola, sekretar i Shoqatës së Endokrinologëve dhe Diabetologëve.

Pjesëmarrës të tjerë: Izedin Bytyçi, sekretar i MPMS, Drin Haraçia, këshilltar në MPMS, Fjolla UKA, KDI dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: **2.11.2016**;
3. Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Arban Abrashi;

Tema:

- Diskutim i procesit të arritjes së marrëveshjes për pensionet me Zvicrën,
- Zbatimi i Ligjit Nr. 04/L-131, për Skemat pensionale të financuara nga shteti.

Takim me shoqatën e diabetologëve;

4. Të ndryshme.

-Informatë rreth vizitës së kryetares së Komisionit, në Kompaninë “Bechtel & Enka “.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 2.11.2016;

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 2.11.2016.

3. Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Arban Abrashi;

Tema:

- **Diskutim i procesit të arritjes së marrëveshjes për pensionet me Zvicrën**

Flora Brovina, kryetare , pasi falënderoi ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Arban Abrashi me stafin e tij, të cilët tha ajo në vazhdimësi po ju përgjigjen ftesave të komisionit, po ashtu falënderoi edhe përfaqësuesin e sindikatës së punëtorëve UNIA nga Zvicra z. Osman Osmani.

Sot, tha Brovina do të diskutojmë rreth procesit të arritjes së marrëveshjes për pensionet me Zvicrën, pra për pensionet e qytetarëve të Kosovës të cilët kanë punuar dhe kontribuar në Zvicër. Ne si komision pothuajse në çdo mandat e kemi shqyrtuar këtë çështje, madje edhe sindikatat të cilat operojnë në Zvicër, të cilat janë shumë aktive dhe në vazhdimësi në detaje na kanë njoftuar ne për këtë problematikë. Madje ne si deputetë kemi vizituar Parlamentin e Zvicrës, ku kemi diskutuar këtë çështje po ashtu kemi zhvilluar debate këtu. Disa kushte që kanë qenë obligim për ti plotësuar kujtojmë se janë plotësuar mirëpo marrëveshja ende nuk është nënshkruar. Andaj kërkojmë nga ju që të na informoni lidhur me këtë çështje se ku është procesi i lidhjes së marrëveshjes për pensionet me Zvicrën edhe vendet tjera si me Gjermani, Kroacinë, Sllovenin, Malin e Zi si dhe shumë vende tjera.

Arban Abrashi, pasi mori fjalën tha se marrëveshja për sigurimet shoqërore e cila ka qenë e lidhur ndërmjet Federatës së Zvicrës dhe Federatës së Ish- Jugosllavisë, pra është ndërprerë vitin 2009, mandej edhe Kosova dhe qytetarët e Kosovës kanë pësuar nga kjo ndërprerje. Kjo është ndërprerë me kërkesë të palës zvicerane për arsye të cilat ata i kanë bërë të ditura dhe nuk është korrekte që ne t'i komentojmë. Pra ka qenë marrëveshje bilaterale dhe çdo shtet apo palë mund të tërhiqet kur vlerëson që nuk po zbatohet apo nuk përputhet me interesat e qytetarëve të saj. Ky problem është bartur nga viti në vit dhe me marrjen e mandatit si ministër i MPMS-së, njeri prej prioriteteve ka qenë edhe kjo çështje apo fillimi i negocimit të marrëveshjes me Zvicrën. Ministria e ka filluar këtë proces dhe paraprakisht e ka dërguar një pyetësor dhe mund të themi kanë filluar bisedimet në nivelin teknik me palën zvicerane, para marrjes së mandatit tim si ministër, diku në vitin 2014. Me marrjen e mandatit në muajt e parë të vitit 2015, ne e kemi vazhduar apo intensifikuar bisedimet me ambasadën e Zvicrës si dhe më autoritetet e Zvicrës në nivelet më të larta. Kemi arritur që të marrim edhe pyetësorin e dytë bazuar në kërkesat e Zvicrës, rreth shqetësimeve të tyre, lidhur me sistemin tonë pensional, sistemin shëndetësor, sistemin e sigurisë së dokumenteve si dhe legjislacionin

aktual. Ne e kemi plotësuar pyetësorin e dytë dhe kemi realizuar kontakte apo takime të suksesshme me personat përgjegjës të palës zvicerane, të deleguar për këtë çështje.

Pala zvicerane ka një praktikë që fillimisht bënë disa pilot marrëveshje në mënyrë që të testojnë sistemin tonë edhe në praktike jo vetëm në bazë të studimit të fizibilitetit apo legjislacionit një praktike të tillë e kanë praktikuar edhe më shtetet tjera. Në fillim të këtij viti kemi nënshkruar një pilot marrëveshje, që nënkupton testimin e shërbimeve tona kundrejt kërkesave të shtetit të Zvicrës si periudhë provuese e cila ka rezultuar e suksesshme. Për njoftimin tuaj, ne kemi marrë lajmin se institucioni përkatës i Zvicrës do të procedojë për Qeverinë e Zvicrës, raportin apo rekomandimin për hapjen e rrugës për nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale për sigurimin shoqëror. Dhe, sot kemi njoftimin që Qeveria e Zvicrës ka kaluar vendimin, ku e ka autorizuar departamentin përkatës që ti fillojë negociatat me shtetin e Kosovës për këtë marrëveshje. Ky është një lajm i mirë për të gjithë, mirëpo, le të kuptohemi, kjo është vetëm hapje e rrugës për këtë marrëveshje.

Sa i përket vendeve tjera, ne kemi filluar negociatat me Belgjikën, Kroacinë dhe disa vende tjera të BE-së, mirëpo, ideja themelore pse ne kemi insistuar që të fillojmë me Zvicrën, ka qenë po qe se ne e nënshkruajmë marrëveshjen me Zvicrën e testojmë mirë sistemin tonë dhe pas kësaj asnjë shtet nuk do të dyshojë në kapacitetet dhe sistemin tonë dhe do të kemi më të lehtë nënshkrimin e marrëveshjeve me vendet tjera. Me Malin e Zi dhe Kroacinë koncepti është paksa më ndryshe, qytetaret kanë kontribuar apo kanë ndarë fonde në fondin pensional të ish- Jugosllavisë, mirëpo, ai fond pensional është marrë dhe vendosur në Serbi. Ata kërkojnë fonde nga buxheti i Kosovës, pra nuk është fondi në të cilin realisht kanë kontribuar por buxheti apo sistem pensional i bazuar në taksat e qytetareve tanë. Ministrat paraprakë kanë bërë atë që ka qenë e mundur në njohjen e përvojës së punës, që qytetaret të kenë më të lehtë, që në shtetin tyre përkatës të marrin pensionet e nevojshme.

Flora Brovina : Ky është një lajm shumë i mirë lidhur me vendimin që e ka marrë Qeveria e Zvicrës për fillimin e negociimit të marrëveshjes për sigurimet shoqërore me Kosovën. Sa i përket fondit të pensioneve, i cili është grabitur ku do t'i merrnin pensionet edhe qytetarët e Malit të Zi. A e kemi ne një regjistër të saktë të të punësuarve që kanë paguar në këtë fond, që në të ardhmen të kërkojmë kthimin e këtij fondi nga Serbia?

Arban Abrashi: Po i kemi të gjitha shënimet në administratë pensionale, sado që ka pasur dëmtime gjatë kohës së luftës ekziston një data bazë solide e të dhënave se sa ka qenë numri i gjithë pensionistëve kontributdhënës që nga vitet '80' deri në vitet '90' të shekullit të kaluar.

Ali Berisha: Është një fakt i madh që nga viti 2009 kemi një diskriminim ndaj punëtorëve të cilët kanë punuar në Zvicër. Është dëmtuar shumë edhe buxheti familjar i familjeve të këtyre qytetarëve, pasi që është një numër shumë i madh i tyre që kanë punuar dhe kanë kontribuar në Zvicër. Kjo çështje është trajtuar edhe kohë më parë edhe në Kuvendin e Kosovës dhe janë adresuar disa rekomandime nga Kuvendi, dhe jo të gjitha ato rekomandime me kohë janë adresuar dhe kemi pasur vonesa të mëdha në aprovimin apo fillimin e negociimit të një marrëveshjeje të re me Zvicrën. Është lajm shumë i mirë që Qeveria Federale e Zvicrës ka aprovuar vendimin për fillimin e negociimit të marrëveshjes, mirëpo, nuk do të thotë që automatikisht do të jemi përfitues apo nënshkruar të kësaj marrëveshjeje, pasi që nga Kosova nevojitet një punë e madhe në plotësimin e kriterëve jo vetëm në aspektin ligjor. Duhet të kemi kujdes në aspektin e keqpërdorimeve të atyre marrëveshjeve apo kontratave nga individë të caktuar pasi që këto kanë qenë një nderë pengesat për Zvicrën. Qeveria duhet të këtë një kujdes të madh, pasi që keqpërdorimet e tilla mund ta shtyjnë edhe për vite të tëra nënshkrimin e marrëveshjes me Zvicrën.

Ndërsa, sa i përket pensioneve nga Serbia, mendoj se qysh në start të fillimit të bisedimeve ka qenë e domosdoshme që të hyjë si çështje e diskutimeve me Serbinë Fondi Pensional i Kosovës, mee

ç'rast janë dëmtuar shumë pensionistë dhe Qeveria duhet të ketë për bazë dhe të shqyrtojë mundësinë që sa më parë të trajtojë çështjen e kthimit të këtij fondi.

Besa Baftiu: Prej fillimit të këtij mandati këtë çështje e kemi diskutuar me ministrin Abrashi, pasi ka qenë problem që ka prekur shumë qytetarë. Qeveria është dashtë që të merret më seriozisht me këtë problematikë, jo vetëm kjo Qeveri por edhe ajo e kaluara, prej kohës kur është prishur kjo marrëveshje, dhënia e pensioneve invalidore apo kontributdhënëse për qytetaret e tanë, pra kanë qenë të diskriminuara nga qeveria e Zvicrës, me shkëputjen e njëanshme të marrëveshjes.

Vendimi i marrë për fillimin e negociatave, është një vendim i mirë, mirëpo, nuk do të thotë se nuk është zgjidhja. Këto bisedime në bazë të vendeve të rajonit kanë zgjatur dy deri në tri vite, e edhe në vendimin të cilin e ka marrë sot Qeveria zvicerane shkruan se këto bisedime do të zgjasin dy- tri vite, pra është një periudhë e gjatë. Kush i cakton grupet që do të negociojnë me Zvicrën? A kemi përfaqësues të qytetarëve apo të sindikatave të punëtorëve, të cilët kanë punuar dhe kontribuar në Zvicër? Besoj se edhe një përfaqësim i tyre në këtë grup nga Qeveria jonë do të ishte i mirë pasi që ata janë marrë me këtë çështje prej fillimit dhe pothuajse kanë trokitur në çdo institucion, duke kërkuar të drejtat e tyre.

Osman Osmani: Ne si sindikatë që nga ndërprerja e njëanshme e marrëveshjes nga ana e Zvicrës kemi marrë hapa të caktuar. Kemi bërë peticione dhe ia kemi dorëzuar dy parlamenteve, dy qeverive dhe kemi pas një bashkëpunim edhe me Komisionin Parlamentar të atëhershëm. Ky bashkëpunim fatbardhësisht ka shkuar mirë deri në vitin 2013. Kemi pasur kontakte edhe me këshilltarët e ministrit Abrashi, ku pas një kohë është ndërprerë komunikimi. Ne kemi lobuar në Zvicër, ku është një grup punues i përberë edhe nga njohës të sigurimeve shoqërorë, po ashtu, edhe nga parlamentarë zviceranë të nivelit federal nga të gjitha partitë të cilat kanë ushtruar një ndikim të madh që Departamenti për Punë të Brendshme i Qeverisë Federale të Zvicrës ka komunikuar sot mandatin për të filluar negociatat.

Ajo që na preokupon neve është se çka do të ndodhe me ata që janë prekur apo dëmtuar, të cilët janë kthyer para se me u prishe marrëveshja, e që kanë menduar se me arritjen e moshës së pensionimit do të gëzojnë të drejtën e pensionit. Pra janë diku mijëra persona që janë kthyer dhe të cilët që shtate vite janë diskriminuar, diskriminim që do të vazhdojë edhe me tej, deri në arritjen e marrëveshjes.

Ne jemi të gatshëm që të punojmë me Qeverinë e Kosovës dhe të bashkëpunojmë edhe me partnerët tanë në Zvicër që të përshpejtojmë këtë proces. Ne kemi ekspertë të sigurimeve shoqërore, të cilët kanë qenë të përfshirë në qeverinë e kaluar në palën negociuese. Kërkojmë nga ju si përfaqësues i këtyre që janë dëmtuar apo diskriminuar që të jemi të përfshirë si pjesë e grupeve negociuese dhe nëse ka ndonjë pengesë t'na tregoni se cilat janë pengesat. Të bashkëpunojmë bashke në këtë proces. Të lidhim edhe urën e bashkëpunimit ndërmjet dy komisioneve parlamentare, në të mirë të qytetarëve tanë.

Kryetarja: Ju faleminderit për kontributin që keni dhënë dhe na keni informuar gjatë gjithë kohës për këtë çështje. Një falënderim të veçantë kemi edhe për lobin e parlamentarëve zviceranë të cilët në mandatin e kaluar kanë ardhur dhe na kanë vizituar dhe kemi diskutuar për këtë çështje dhe gjithashtu kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm edhe me ambasadën e Zvicrës në Kosovë. Komisioni do të përcjellë edhe fazën e bisedimeve ndërmjet dy qeverive dhe me arritjen apo nënshkrimin e marrëveshjes, ne si Komision do të shqyrtojmë sa më parë dhe të ratifikojmë në Kuvend.

Fadil Beka: E përgëzoj ministrin për punën dhe angazhimin që e ka bërë. Po të mos kishim një këmbëngulje dhe angazhim të MPMS-së nuk kish ardhur deri të ky vendim për hapjen e

negociatave ndërmjet dy vendeve. Ne i kuptojmë gjitha shqetësimet e qytetarëve, mirëpo, duhet ta kemi parasysh respektimin e procedurave ligjore.

Arban Abrashi: Çështjet e marrëveshjes bilaterale nuk zgjidhen në bazë të emocioneve dhe kërkesave. Realisht janë marrëveshje që përcaktohen në bazë të direktivës së Komisionit Evropian dhe përcakton kushtet dhe aspektet ligjore dhe përfitimit të tyre bazuar në praktikën më të mirë evropiane që kanë kaluar nëpër shumë filtra. Andaj nuk është mirë që të politizojmë këtë çështje. Ideja themelore është që të dërgojmë sinjal që sistemet përkatëse funksionojnë mirë, legjislacioni është i avancuar, respektohen të drejtat e njeriut, respektohet siguria e dokumenteve, keqpërdorimet janë zero. Këto janë ato kushte që kërkohen dhe ne jemi fokusuar në këto çështje.

Ne kemi angazhuar ekspertë nga Banka Botërore, të cilët punojnë për ne jo vetëm për pensione. Po ashtu, Fondi Monetar ka përkrahur prej ditës së parë me projekte dhe ekspertë, ndërsa kemi kërkuar ndihmë nga Shqipëria, pasi që kanë një përvojë të madhe sa i përket marrëveshjeve të tilla.

Besa Baftiu: Grupi i cili do të negociojë marrëveshjen me Zvicrën është mirë të ketë edhe përfshirje të njerëzve të cilët janë të inkuadruar në politik atje dhe të cilët mund të ndihmojnë shumë me lobim. Pra Partia Popullore Zvicerane është partia e cila e ka iniciuar këtë çështje që të ndërpritet kjo marrëveshje. Kjo parti e ka shumicën në parlament dhe kemi nevojë për mbështetje dhe lobim të njerëzve tanë që veprojnë dhe punojnë në Zvicër.

Arban Abrashi: Ne e propozojmë përbërjen e grupit që do të dërgohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme, mandej miratohet në Qeveri. Patjetër se do të marrim parasysh të gjithë ato organizata apo njerëz të cilët mund të kontribuojnë në këtë proces.

- **Zbatimi i Ligjit Nr. 04/L-131, për Skemat pensionale të financuara nga shteti**

Flora Brovina: Kemi pranuar një shkresë nga Sindikata e Pavarur e Administratës së Kosovës-SPAK, lidhur me Ligjin mbi skemat pensionale të financuara nga shteti, të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre për moszbatimin dhe paqartësinë e dispozitave të këtij ligji respektivisht nenit 8 paragrafi 1, pika 2, Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës respektivisht neni 8, paragrafi 6, ku thuhet *“Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.”* Andaj kjo pjesa e dytë e fjalisë *“dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*. Pra edhe kur është miratuar ky ligj kemi pasur polemika të shumta rrethë kësaj, e cila tash po hasë në vështirësi sa i përket zbatimit të kësaj dispozite. Andaj, kjo sindikatë ka kërkuar që të dijë se kush janë këta të tjerët, cila kategori. Urdhëroni z. Ministër na njoftoni lidhje me zbatimin e këtij Ligji, respektivisht të kësaj kategorie.

Arban Abrashi: Ne kemi filluar zbatimin e kësaj dispozite edhe përkundër që ka pasur paqartësi, pra kjo dispozitë ka kaluar në Kuvend, kur është miratuar ky Ligj dhe nuk ka ardhur propozimi në këtë mënyrë nga Qeveria. Pra, me sa e dimë ka qenë propozim apo amendament i propozuar direkt në seancë edhe është miratuar. Prandaj, vetë fakti që ka kaluar si i tillë lenë hapësirë për të pasur paqartësi gjatë zbatimit. Ne kemi filluar me zbatim aq sa kemi pasur mundësi, pra kemi filluar me punëtorët e arsimit për arsye se kemi edhe të dhëna të bazuara dhe të sakta nëpër komunitet e Kosovës, pra drejtoritë e arsimit. Kemi filluar me njohjen e përvojës të të gjithë punonjësve të arsimit të cilët kanë punuar gjatë viteve 90'. Tash jemi duke punuar me sektorin tjetër, atë të shëndetësisë. Fillimisht me definimin e të dhënave se sa punëtorë kanë punuar në këtë sektor. Pasi ti kemi të dhënat e sakta për ta, do të shkojmë me kalkulimin e tyre dhe varësisht nga buxheti do të shkojmë me njohjen e përvojës së punës.

Kurse sa i përket tek “të tjerët” ne kemi diskutuar se kush mund të jetë në këtë kategori. Ka ide të ndryshme, qoftë këshillat për financim, policisë ose strukturave që kanë punuar në sektorin e sigurisë, pra ende jemi në diskutim e sipër se kush mund të hyjë tek kjo kategori. Duhet të nxjerrim një akt nënligjor ku do të listojmë ato kategori që mund të hyjnë këtu dhe cilat kritere duhet ti plotësojnë.

Ali Berisha: Kur kërkohet zbatimi i ligjeve të miratuara mos konsideroni se po bëjmë politikë. Kërkesa për zbatim të ligjeve është e drejtë se ligjet të cilat janë aprovuar gjithsesi duhet të zbatohen. Jo vetëm kjo çështje që është ngritur nga sindikata, unë kisha shtuar edhe disa çështje përveç asaj që të njihet stazhi prej viteve 90’ deri 99’, nuk mendoj se duhet të jenë vetëm punëtorët e arsimit kur dihet se edhe në atë periudhë ka pasur ministri të shëndetësisë dhe ka pasur punëtorë shëndetësorë dhe besoj se ka të dhëna të sakta për të gjithë ata të cilët kanë qenë të angazhuar në këtë sektor. Pra edhe këtyre punëtorëve duhet t’ju njihet stazhi i punës.

Çështje tjetër është kategorizimi i shfrytëzuesve të pensioneve kontributdhënese në nenin 8 pika 2. Mendoj se edhe ne këtu kemi një paqartësi. Pasi që jo vetëm kategoritë e shkollimit duhet ti merrni për bazë por kjo vlen edhe për minatorët e Trepçës, pasi që ata kanë përvojë të caktuar dhe trajnime të caktuara mujore apo vjeçare dhe nuk janë të futur në skemat e caktuara kontributdhënese, kualifikimet e tyre. Çështje tjetër është çështja e pensioneve të punëtorëve të Trepçës, sidomos të një periudhe të caktuar 89 – 90, ku nuk është një numër i madh i tyre. Ata meritojnë që pas skadimit të afatit të kohës së pensioneve kontributdhënese dhe pas skadimit të moshës 65 vjeçare, të ju vazhdohet e njëjta dhe të mos vazhdohet në pensionet bazike të moshës. Ata duhet të trajtohen si kategori e veçantë e shoqërisë për kontributin që kanë dhënë në një periudhe të caktuar kohore. Kurse çështja tjetër që dua të ngrihet është nenin 14 i këtij Ligji, pra çështja e rritjes së pensioneve bazuar në koston e jetesës.

Besa Baftiu: Pajtohem plotësisht me kolegun z. Berisha dhe kryetaren që i potencoi problemet lidhur me zbatimin e këtij ligji. Mirëpo me ligj përcaktohet edhe skema e pensioneve familjare edhe invalide, ku thuhet se do të fillojë të zbatimi në janar 2015, kurse ne jemi tash ka fundi i vitit 2016 dhe ende nuk kanë filluar së zbatuari këto dy skema.

Po ashtu, për minatorët, ku ka mbetur ky proces, apo ku është problemi që nuk po zbatohet e drejta e minatorëve që s’po i marrin pensionet, kur ka pasur raste që për një vit apo gjysmë viti nuk i ka përmbushur këto kritere.

Arban Abrashi: Te kategorizimi, ne kemi filluar zbatimin e ligjit pothuajse bas gjashtë muajsh me organizata si me Lidhjen Pensionistëve dhe grupet e interesit, me ç’rast jemi dakorduar që të dalim me një udhëzim, ku përfaqësohen dhe përmbledhen interesat e tyre sa ma mirë. I kemi njohur dy kategoritë që i parasheh Ligji, si në njohjen e përvojës së punës si kohëzgjatje si dhe kualifikimet. Pasi që kemi filluar më zbatimin kemi hasur në kërkesa të shumta nga punëtorët që kanë punuar në ndërmarrje të mëdha si KEK-u. Trepça. Ferronikeli, të cilët kanë pasur trajnime në ato fusha dhe kanë kërkuar që këto trajnime të jenë barasvlershme me njërën nga kërkesat-kriteret. Ne si ministri nuk kemi kapacitete ti njohim apo ti vlerësojmë se në cilën kategori kish me qenë një trajnim dhe në këtë rast kemi kërkuar ndihmë nga MASHT-i apo Agjencia e Akreditimit, për të na ndihmuar në këtë çështje. Te punëtorët e Trepçës ne kemi pasur probleme se një numër i madh i tyre s’kanë mundur ta sigurojnë dokumentacion dhe nuk e kanë dëshmuar se kanë përvojë të punës sa kërkohet në ligj, mirëpo, me disa ndryshime që do të ndodhin në legjislacion besoj se do të përmbushën edhe kërkesat e tyre, pra duhet të bëhen ndryshime ligjore të cilat besojmë se do ti sjellim në një pako ligjore gjatë muajit në vijim.

Kurse, tek rritja e pensioneve, ne kemi bërë rritjen e pensioneve kontributdhënese kurse në pensionet tjera nuk ka pasur rritje. Këtë s’mundëm ta bëjmë për shkak të presionit të madh

buxhetor nga skemat e reja. Jemi angazhuar në kursim të mjeteve, pra kemi nxjerr një udhëzim administrativ, përmes të cilit kemi kërkuar dokumente shitesë për të gjithë. Por jo dokumente që janë të vështira që të sigurohen. Ju kemi kërkuar një prej faturave, në pronë, apo të shërbimeve komunale që të dëshmojnë se një pensionist po jeton apo ka pronë pra është rezident në Kosovë, siç kërkohet me ligj.

Sipas ligjit, përfituesit duhet të jenë banorë të përhershëm. Pra te kjo skemë e pensioneve bazë, ne i kemi suspenduar mbi 18.000 (tetëmbëdhjetëmijë) të cilët nuk kanë dëshmuar se janë banorë të përhershëm në bazë të kriterëve që parashihen. Besojmë se më kursimet dhe me menaxhim më të mirë të këtyre skemave, vitin e ardhshëm mund të bëjmë edhe rritjen e disa skemave si dhe të fillojmë më skemën invalidore dhe familjare.

Flora Brovina: Në bazë të ankesave që kemi në Komision, vërejmë se disa apo shumica prej tyre janë gra që nuk po mundën ti gjejnë dëshmitë për një vit apo disa muaj gjatë periudhës së pushimit të lehonisë, nuk ju janë paguar kontributet apo s'po mundën ti sigurojnë dëshmitë. Dhe për një periudhë shumë të shkurtër s'po e përmbushin kriterin prej 15 viteve për pension kontributdhënës.

Arban Abrashi: Po është si dukuri me të cilën edhe ne jemi ballafaquar dhe e kemi diskutuar, mirëpo, Ligji e përcakton shumë qartë se duhet ti kenë 15 vite përvojë punë dhe kontribut në sistemin e përhershëm apo në këtë rast në fondin pensional dhe invalidor, në mënyrë që të gëzojnë këtë të drejtë. Kjo çështje mund të adresohet përmes ndryshimeve ligjore.

Kurse, sa i përket rasteve që kanë shqetësim se vetëm periudhën e pushimit të lehonisë s'janë deklaruar ose nuk është paguar stazhi, le të adresohen tek ne në ministri dhe do të shohim se ku është problemi, dhe do të shohim në arkiva lidhur me këto shqetësime.

4. Takim me shoqatën e diabetologëve;

Flora Brovina, përshëndeti përfaqësuesit e Klinikës së Diabetologëve si dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Diabetologëve, të cilët iu kanë përgjigjur ftesës për të diskutuar për sëmundjen e diabetit, me rastin e ditës së diabetit.

Kërkojmë nga ju që të na njoftoni me gjendjen e të sëmurave me diabet në Kosovë dhe mundësitë e shërimit. Sa persona kemi me diabet, këndë e atakon më shumë si dhe në fund mjekimi i tyre si dhe problemi që keni theksuar në konferencë lidhur me insulinën, furnizimin dhe kualiteti i saj, ndërsa fjalën ia dha Bardhyl Gashit.

Bardhyl Gashi, shef i diabetologjisë dhe kryetar i Shoqatës së Endokrinologëve dhe Diabetologëve të Kosovës, tha se 5 deri 7 % e popullatës së Kosovës janë me diabet. Statistika të sakta nuk kemi mirëpo sipas të dhënave që kemi, janë diku rreth 12 000 deri 15 000 persona, ku prej tyre 750 deri 800 janë fëmijë nën moshën 18 vjeçare. Ne kemi shkuar për të marrë insulinën, mirëpo nuk e kemi pranuar për shkak të kualitetit apo llojit që na është ofruar. Ne kemi kërkuar insulinë humane kurse na është ofruar insulinë bio-semilare e ngjashme me këtë humane, mirëpo, nuk është humane. \

Sa i përket fëmijëve, nuk kemi problem se ata i kemi mbuluar mirë, fëmijët janë duke e marrë insulinën analoge të mirë, të cilën e kemi pranuar nga Ministria e Shëndetësisë. Sa i përket fëmijëve, do të ishte më mirë që të furnizohemi më trake për fëmijë, pasi që ata deri në gjashtë herë në ditë duhet të bëjnë matjen e sheqerit në gjak, pasi ata varësisht nivelit marrin insulinën me veprim të shpejte-rapid edhe atë me procedure të gjatë.

Kryetarja: Traket fëmijët apo familjet e tyre i blejnë vetë, apo si?

Bardhyl Gashi: Po, fatkeqësisht vetë i blejnë. Po e përsërisë, sa i përket fëmijëve ata e kanë insulinën edhe rapidin edhe insulinën me veprim të gjatë. Pra, problemi ekziston tek pacientët e rritur, pasi që ne kemi pacientë që ka terapi perorale dhe kemi me insulinë. Kemi shqetësime nga pacientët pasi që kanë filluar të marrin këtë insulinë bio-semilare. Kemi hulumtuar në vendet e regjionit, ky lloj i insulinës nuk përdoret, e pse tek ne po. I kemi dhënë tri propozime, mirëpo, na është thënë se procedurat e prokurimit, çmimi më i lirë i ofertuesve.

Kryetarja: A e dini ju se sa është çmimi apo dallimi në mes këtyre të dyjave si dhe ku është dallimi prej asaj insulinës humane ?

Bardhyl Gashi: Sinqerisht nuk jam në dijeni rreth çmimit të tyre. Problemi kryesor është se nuk janë pena po janë me getrigja, kisha janë me mbushje automatike sipas tyre. Ata të cilët e kanë përdorur këtë lloje të insulinës kanë pasur çrregullime tërësisht të diabetit apo në rregullimin e sheqerit.

Hatim Baxhaku: A është problemi tek dozimi apo tek kualiteti i insulinës?

Bardhyl Gashi: Problemi është tek të dyjat, edhe dozimi edhe kualiteti i saj. Në treg edhe prej Ministrisë ne tash kemi edhe Novomixa por analog. Jemi të detyruar që të përshkruajmë këtë pasi që është më i mirë. Ne kemi kërkuar humane, mirëpo kjo nuk është humane.

Besa Baftiu: Cila është përgjigja e Ministrisë për këtë?

Bardhyl Gashi: Arsyeja e tyre ka qenë se jemi të obliguar të respektojmë Ligjin e prokurimit. Dhe krejt bota furnizohet prej tri kompanive më të forta që prodhojnë insulinën Novonordisku, Elillyllin dhe Sanofin, pse tek ne nuk furnizohemi prej këtyre prodhuesve?

Ali Berisha: Si shef i Klinikës dhe si kryetar i shoqatës a konsultoheni ju kur përgatitet specifikacioni për tenderim të barnave nga ministria apo ministria e përgatit specifikacionin vet pa ju konsultuar juve?

Bardhyl Gashi: Unë kamë qenë në bisedime me ministrinë, atë që ua thash juve sot këtu, ua kam thënë në ministri. Këtu me mua është edhe dr. Luan Gola, njëherësh sekretar i shoqatës.

Luan Gola: Fatkeqësisht nuk kemi të dhëna të sakta për shkak të mosfunksionimit të sistemit informativ shëndetësor, mirëpo, në Kosovë një numër i madh i pacientëve që trajtohen me diabet e kanë edhe shkallen e lartë të komplikimeve e cila shkon mbi 60 %. Po ashtu, problemet tjera të cilat trajtohen apo komplikimet e sëmundjes së diabetit janë mjaftë të kushtueshme dhe një pjesë e madhe e tyre kryhet edhe jashtë shërbimeve publike apo në sektorin privat. Insulinat ndahen në dy grupe, në insulinë humane dhe analoge apo insulina moderne, të cilat vijnë si rezultat i kombinimit gjenetik që bëhen në zinxhirin e insulinës, meqenëse ju është ndërruar farmako-kinetika e barit. Ne kemi pasur fatin që tri vite të kemi ato në Kosovë. Ju e dini që në Kosovë shkohet me procedurë të prokurimit dhe sigurohet për të gjithë pacientët. Ne tash jemi kthyer një hap mbrapa si Kosovë pasi

që është diçka tjetër insulina humane nga ajo bio-semilare. Andaj ne kërkojmë që të vazhdojmë më furnizim më insulina humane pasi që ky bari ka një ndikim të madh tek personat që e përdorin insulinën.

Po ashtu, sa i përket test trakave për matjen e glikemisë tek fëmijët kërkojmë që të mundësohet sigurimi i tyre, pasi që nuk është një kosto e lehtë apo e përballueshme për familjet e këtyre fëmijëve. Ne kemi pasur një vizitë nga sekretari i IDEF-së, është organizate ndërkombëtare e diabetit dhe shumë shpjet do të aplikojmë që të jemi pjesë e kësaj organizate.

Ne vitin 2006, Asambleja e Kombeve të Bashkuara e ka përgatitur një tekst të shkruar apo rezolutë për sëmundje të diabetit, pra është një sëmundje ku vetëm vitin e kaluar ka shpenzuar mbi 680 miliardë dollarë në botë, apo diku 15 % të buxhetit apo medikamenteve, kurse tek ne është diku 12 % e buxhetit për barna që shpenzon pra është shpenzuesi më i madh i fondeve për shëndetësi. Andaj ne kemi përgatitur një draft rezolutë se si duket, ku shumë shtetet e kanë miratuar këtë rezolutë dhe kërkojmë shqyrtimin e mundësisë që në të ardhmen ta miratoni në komision dhe mandej edhe në Kuvend.

Luan Gola: Periudha prej momentit që ne jemi njoftuar se jemi furnizuar me këtë lloje insulinë se mënyra e shpërndarjes shkon nga Ministria e Shëndetësisë tek qendrat kryesore të Mjekësisë Familjare, pra diku tash dy muaj e gjysme ka mbërri dhe ka filluar shpërndarja e saj.

Ne kemi bërë kërkesë që disa vite rresht që të krijohet regjistri i saktë për pacientët që janë me diabet dhe mund të gjinden edhe sponsorë për këtë çështje, mirëpo, ne ende nuk e kemi një regjister të tillë. Ka që dy muaj që pacientët kanë filluar që të marrin këtë lloj të insulinës dhe ne si mjek duhet ti kemi rezultatet në terren, mirëpo, problemi do të jetë si në aspektin e kualitetit sepse po duhet me shkua me doza shumë më të larta dhe problemi tjetër është teknik tek çështja e dozimit.

Kryetarja: Ne si komision do të adresojmë këtë çështje në Ministrinë e Shëndetësisë ku do ti parashtrijmë dhe pyetje apo do të ftojme ministrin që të raportoj për këtë çështje. Draft rezolutën që na dorëzuar ne do të shqyrtojmë mundësin që të adresojmë dhe të shqyrtojmë mundësinë të procedojmë për miratim në Kuvend. Ne ju falënderojmë që ju keni përgjigjur ftesës së komisionit dhe ne të kemi informatën e drejtpërdrejt nga ju lidhur me sëmundjen e diabetit si dhe problemin e furnizimit me insulinë. Në të ardhmen bashkërisht duhet të diskutojmë me gjerësisht për një plan nacional që duhet të kemi për luftë kundër diabetit. Lidhur me fëmijët që janë të prekur nga sëmundja e diabetit do të mundohemi që të kemi një takim me UNICEF dhe të shqyrtojmë mundësin e furnizimit me barna të nevojshme për këta fëmijë.

5. Të ndryshme.

Flora Brovina, kryetare, i njoftoi të pranishmit rreth në kompaninë Bectel Enka, kompaninë e cila është duke kryer autostradën Prishtinë –Shkup. Qëllimi i vizitës, tha Brovina, në bazë të disa njoftimeve që kishim, kishte të bënte në lidhje me punësimin e punëtorëve të huaj (nga Rumania) dhe përjashtimin e punëtorëve vendorë, mirëpo, sipas asaj që na deklaruan personat përgjegjës të kësaj kompanie kjo nuk qëndron. Në bazë të marrëveshjes të Bectel Enka dhe Qeverisë tonë, kompania duhet të punësojë punëtorë vendorë, mirëpo edhe punësimin e punëtorëve të huaj apo kuadro që s'mund të gjenden në tregun vendor. Sipas drejtorit Christof Jennions, ata kanë të punësuar 2 000 (dy mije) punëtorë dhe ky numër lëviz varësisht prej sezonit. Tash për tash 80% e punëtorëve janë vendorë kurse vetëm 20% janë punëtorë të jashtëm apo të huaj. Së fundi kanë punësuar 19 punëtorë nga Rumania, sipas tyre ekspertë të riparimit apo mirëmbajtjes së makinerisë së rëndë punuese, pasi nuk kishin vendorë. Sipas marrëveshjes së tyre me Qeverinë tonë, punësimi i

punëtorëve bëhet nga regjioni nëpër të cilin kalon traseja e autostradës dhe kjo i ka obliguar që shpesh të largojë dhe punësoj punëtorë të rinj të lokacionit ku kanë qenë duke u kryer punimet. Për secilin të punësuar ofrohen trajnime për sigurinë në punë dhe sigurinë teknike, ndërsa na njoftuan se kanë një bashkëpunim të mirë edhe me Inspektoratin e Punës dhe MPMS-në.

I kemi dy kërkesa që kanë të bëjnë me buxhet, njëra nga HANDIKOS, lidhur me buxhetimin apo zbatimin e Ligjit për paraplegjikë dhe tetraplegjikë, i cili ka qenë i planifikuar që të fillojë zbatimin që nga janari i këtij viti dhe nuk është planifikuar buxhet as për vitin 2017. Komisioni vendosi që në mbledhjen ku do të diskutohet për buxhetin, do të trajtohen edhe kërkesat e veçanta për buxhet, ku do të shqyrtohen mundësitë për përgatitjen e rekomandimeve apo amendamenteve të Komisionit lidhur me buxhetin në sektorin shëndetësisë dhe mirëqenien sociale.

Do të shqyrtojmë mundësinë që ta thërrasim ministrin e MPMS-së që të jep shpjegime pse nuk është mbuluar me kosto zbatimi i këtij ligji për këtë kategori.

Kemi edhe kërkesë nga Komuna e Graçanicës, për ndarjen e 200 000 € për vazhdimin e punimeve për ndërtimin e spitalit rajonal në Graçanicë, i cili ka filluar të ndërtohet në vitin 2010. Pas shqyrtimit, Komisioni kërkon që shkresa të jetë më e specifikuar apo e arsyetuar më mirë dhe kjo pastaj ti përcillet Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa.

Flora Brovina: Do të vazhdojmë me monitorimin e Ligjit të Shëndetësisë me vizita në institucionet e veçanta, lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore brenda qendrave korrektuese në Dubravë dhe Lipjan si dhe në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, Qendrën për Integrim dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik –Shtime, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë si dhe Qendrën e Pëlqeve në Prishtinë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA